

# Spitali psikiatrik i Lucie Leanne, vjen përmes librit në Panairin e Librit



GazetaExpress

E premte, 09 Qershor 2017 20:09

**“Zërat e bisedave ngadalë largohen, shkrihen. Ora 14:00 nuk thotë asgjë për mua. Koha ka ndalur me futjen në spital një ditë nëntori.**

Para kësaj, ndërtesa e lartë ngjyrë shkumësi ka hequr dorë prej nesh duke na parë të vijnë vërdallë , ne: të çmendurit”, janë vetëm disa rreshta nga romani më i ri poetik i autores Lucie Léanne që u promovua sot në Panairin e Librit në Prishtinë, shkruan KultPlus.

Romani i tretë i autores franceze i titulluar “Kufiri” sjellë jetën e pacientëve të mbyllur brenda katër mureve të një spitali psikiatrik.

Vetë autorja mahniti të pranishmit me falënderimin e saj në gjuhën shqipe.

“Kjo është një ditë e madhe për mua sepse romani im “Kufiri” është paraqitur në Panairin e Prishtinës”, tha Leanne në shqip, për të cilën është hera e parë që gjendet në Kosovë.

”Sapo mbërrita në Kosovë më pëlqeu atmosfera e këtij qyteti, më pëlqeu mënyra se si gjendet edhe moderniteti edhe arkaikja së bashku dhe ndihem shumë e lumtur nga pritja që më është bërë këtu në Kosovë”, vazhdoi ajo duke shpjeguar më tutje se në këtë libër është munduar të tregojë gjithashtu se çdo situatë dramatike ka gjithmonë një zgjidhje.

Ndërkaç, Anila Xhekaliu -përkthyesja e romanit në gjuhën shqipe tha se ky roman është një risi jo vetëm në letërsinë franceze por edhe në letërsinë e vendeve të tjera.

“Besoj se ky roman është një risi jo vetëm në letërsinë franceze por edhe në letërsinë e vendeve të tjera. Ana poetike qëndron mbi nivelet e tjera të tekstit përkatësisht me botën shpirtërore të personazhit, të autores që na e rrëfen këtë botë brenda katër mureve. Kjo poetikë ka dhënë botën e brendshme të narratores që besoj jo rastësisht quhet Milena, shkrimtarët më Milenën shkojnë direkt tek e dashura e Franc Kafkës, pra bëhet një hyrje në letërsinë e madhe të shekullit të njëzetë të absurdit, të romanit të rrjedhës”, tha Xhekaliu duke shtuar se ana poetike në këtë roman qëndron mbi të gjitha nivelet e tjera të tekstit.

Ndërsa, Abdullah Zeneli nga shtëpia botuese “Buzuku” e cila edhe ka sjellë në shqip romanin “Kufiri”, falënderoi autoren për dhënien e të drejtës së botimit të librit edhe në gjuhën, që sipas Zenelit është një kryevepër me të cilën do të habiten të gjithë.

Ndryshe,edicioni i 19-të i panairit të Librit në Prishtinë është hapur të martën dhe do të qëndrojë i hapur deri të dielën. KultPlus.com


**Data:** 09 Qershor 2017 20:09

---

**Autori:** GazetaExpress

---

Artikull i sponsorizuar



• [Koha e drekës është pjesa e vetme e ditës ku askush nuk mund të më thotë çfarë të bëj. Dua të bëj maksimumin prej...](#)